

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë dhe qytetarë që na ndiqni,

Debati që po zhvillojmë sot është kërkuar nga 15 kolegë deputetë të opozitës dhe është një debat jashtëzakonisht i rëndësishëm për shoqërinë tonë, vetëm se duhet të citojmë një fakt: ata janë një vit e gjysmë me vonesë.

Një vit e gjysmë më parë, kur bota dilte nga pandemia globale me një dëshirë për të rritur ekonominë, për të fituar të gjithë kohën e humbur dhe për të ndezur motorët e fikur, kur kërkesa për energji u shumëfishua në krahasim me ofertën e energjisë, çmimi i energjisë u rrit dhe ishte ky momenti kur Kryeministri dhe ministrja e Energjisë në atë kohë, sot zëvendëskryeministre, ndezën menjëherë llambën e alarmit, sinjalizuan shoqërinë tonë për ditët e vështira që do të vinin. Në momentin kur në shkurt kriza e energjisë u ul këmbëkryq, sepse tubacionet e gazit, që kalonin përmes Ukrainës, ishin nën kërcënimin e tankeve ruse të Putinit dhe çmimi i energjisë shkoi nga 30% në 50% (e dëgjua dhe e pamë që u katërfishua, u tetëfishua, madje u dhjetëfishua, po të doni), qytetarët tanë vazhduan të paguanin të njëjtin çmim energjie.

U tha e u stërtha nga të gjithë ata që e kuptojnë energjinë se kjo qeveri, shumica socialiste e ka mbështetur në tri shtylla strategjinë për të menaxhuar krizën energjetike.

Në radhë të parë, mbron konsumatorin, mbron qytetarët, mbron çdo familje. 28 miliardë lekë janë deri tani mburoja energjetike për çdo familje shqiptare, fatmirësisht për të gjithë pensionistët, sikurse edhe nëna ime, dhe fatkeqësisht edhe për ata që sapo dëgjua që kanë shtëpi të dytë apo të tretë, por që nuk i kanë shpëtuar vëzhgimit tonë, ndaj dhe kemi propozuar fashën. Ata që harxhojnë dhe shpenzojnë më shumë, siç mund të jetë shumica jonë këtu, nuk mund të paguajnë njësoj si ata që nuk kanë mundësi të mbulojnë shpenzimin e energjisë në këto momente. Kështu që mburoja energjetike është konkrete. Janë 28 miliardë lekë që kanë dalë nga buxheti i shtetit, madje e gjithë kriza energjetike, e përkthyer në krizë çmimesh në ekonominë shqiptare, ka marrë një mburojë tjetër, që është mburoja sociale, për të cilën foli zëvendëskryeministrja, foli Kryeministri, foli ministrja e Financave dhe kanë folur shumë nga ne. Çuditërisht gjithçka që ne themi bie në vesh të shurdhër në këtë sallë, por jam i sigurt që dëgjohet nga ju, qytetarë, që po na ndiqni. Bëhet fjalë për 43 miliardë lekë, që kanë shkuar për indeksimin e pensioneve, për rritjen e pagave të infermierëve, mjekëve, ushtarakëve, policëve, të të gjithë atyre që janë në ballë të shërbimeve publike. Ndërkohë, 8,5 miliardë është transferta për të ndihmuar familjet në nevojë, nënat e vetmuara dhe me shumë fëmijë e halle.

Kështu që mbrojtja e popullatës në këtë kohë lufte, kur kriza energjetike ka ardhur për shkak të luftës, dhe këtë e di i madh e i vogël, është shtylla e parë e strategjisë sonë. E dëgjua zëvendëskryeministren teksa i shpjegonte këto dhe përsëri refuzoni të dëgjoni e të kuptoni, por jam i bindur se qytetarët kuptojnë shumë më mirë.

Shtylla e dytë është nxitja e kursimit.

Me lejoni të paraqes disa fakte.

Më 6 tetor Franca bëri një parakalim ministror për të nxitur kursimin e energjisë, konkretisht, kursimin e ngrohjes së pishinave, kursimin përmes ngadalësimit të shpejtësisë së makinave, dhe nuk qeshi njeri në Francë.

Më 11 tetor Spanja filloi të njëjtën fushatë të nxitjes së kursimit, dhe askush në Spanjë nuk qeshi; përkundrazi, kuptuan se të pambrojturit duhet të mbrohen patjetër, por nga ana tjetër duhet të kursenin energji. Ndaj çdo fushatë, çdo sensibilizim për uljen e konsumit të energjisë është gjëja e duhur.

Ndërkohë, kur del qeveria jonë, e cila shpalos planin dhe thotë se do të ulim konsumin dhe ul 15% nga konsumi i institucioneve shtetërore, ju qeshni. Ju aludoni kursimin e kohës së komunizmit; ju filloni të merreni me lavatriçe dhe me frigoriferë, kur është e vërtetë që të gjithë ne mund të kursejmë nga përdorimi i tyre, mund të kursejmë nga përdorimi i automjeteve tona. Zëvendësministrja e shpjegoi shumë mirë që ka shkuar në 15% reduktimi i konsumit vetëm nga politikat e nxitjes së kursimit.

Shtylla e tretë është rritja e prodhimit. Një koleg imi parafolës, ish-ministri i Energjisë, zoti Gjikhuri, foli për dyfishimin e prodhimit vetëm në 8 vjetët e fundit, ndërsa zëvendëskryeministrja i përmendi të gjitha me radhë: centralet lundruese, të cilat fillojnë punë në janar; impiantet fotovoltaike, që kanë filluar prodhimin 100 mega; Skavicën, për të cilën andej nga fundi dëgjohej kur thoshin: “Harroje! Harroje! *Forget it*”, se, në fakt, flasin anglisht, por janë kundër amerikanëve.

Të nderuar kolegë,

“Petroputinizmi”, për ju që ndoshta jeni duke vlarë mendjen se çfarë është, është politika e Kremlinit, që nëpërmjet parave të karburantit (të petrolit) të ushtrojë ndikimin e tij në të gjitha vendet e Europës. Petroputinizmi nuk ka brirë. Ai financon parti; tallet dhe qesh kur sinjalizohen rreziqet e varësisë energjetike, rreziqet e rritjes së çmimit të energjisë; sulmon kur mbrohen të pambrojturit; përpiqet të nxisë kryengritje në momentin kur ne jemi në luftë dhe përpiqemi të strehohim ata të cilët vërtet kanë nevojë të mbrohen; shpërdoron kur ne kursejmë.

Dëgjuam fare mirë këtu se si gjysma e energjisë shkonte kot dhe ne nuk merrnim asnjë kokërr leku, ndërkohë që sot e kemi evituar atë humbje, madje flitet sikur ne kemi bërë namin. Por ju ishit mbretërit e errësirës, si mund të flisni për këtë gjë? Janë shitur pasuri kombëtare, ndërkohë që ne ndërtojmë pasuri kombëtare.

Për ta mbyllur diskutimin, do të doja t’ju falënderoja që e keni sjellë si çështje, por do t’ju lutesha të vinit me një strategji që e konkurren këtë strategji, që konkurren me mbrojtjen e të pambrojturve, që konkurren me nxitjen e kursimit, me rritjen e prodhimit dhe të mos flisni broçkulla! Faleminderit!